




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË



NIPT. M01321051K

Nr.37/2021.Dosje/Nr. 520.Prot.

Tiranë, më 10.07.2021

URDHËR

(PËR VENIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE)

Drejtuar: Qendres Kombetare te Biznesit QKB-Tirane

Une Endrit Hasa, me detyre Permbarues Gjyqesor dhe NIPT M01321051K, në referim të Titullit Ekzekutiv, Vendimin Nr.158 date 02/06/2021 te Gjykates se Apelit Tirane, kam vënë në ekzekutim kete Titull, duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr.37/2021, datë 25.06.2021, kërkesën e kreditorit Av. Elton Gongo PF me Nipt K72216016B, ndaj debitorit Shoqeria "Arlis-Ndertim" shpk, me NIPT K82116012N, pasi studiova materialet e dosjes përmbarimore Nr.37/2021, datë 25.06.2021, konstatoj se:

Në bazë të Titullit Ekzekutiv, Vendimin Nr.158 date 02/06/2021 te Gjykates se Apelit Tirane, është vendosur :

1. *Ndryshimin e vendimit nr.2699, date. 15.04.2019 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane si vijon;*
 - a. *Pranimin e pjeseshem te padise.*
 - b. *Detyrimin e te paditurit "Arlis Ndertim" shpk qe ti paguaje paditesit Elton Gongo shumen prej 7.735.275 (shtateqind e shtateqind etridhete e pesmije e dyqind e shtatedhete e pese) leke, qe I korespondon detyrimin deri ne daten 04/12/2018.*
 - c. *Detyrimin e te paditurit "Arlis Ndertim" shpk qe ti paguaje paditesit Elton Gongo shumen prej 1.060 (njemije e gjashtedhete) leke ne dite duke filluar nga data 05/12/2018 deri ne ditën e ekzekutimit te vendimit.*
 - d. *Rrezimin e kerkimeve te tjera te padise.*
 - e. *Shpenzimet gjyqesore I ngarkohen paleve ne raport me pjesen e pranuar dhe rrezuar te padise.*
2. *Ky Vendim perben titull ekzekutiv dhe ngarkohet sherbimi permbarimor per ekzekutimin e tij.*
3. *Kunder ketij vendimi mund te behet recurs ne Gjykatën e Larte, brenda 30 diteve, duke filluar nga e nesermja e njoftimit te vendimit te arsyetuar.*
4. *U shpall sot ne Tirane, me date 02.06.2021.*

Bazuar në nenin 517 të Kodit të Procedurës Civile, paragrafët I dhe II të tij, lajmërova dhe kërkova përmbushjen dhe ekzekutimin vullnetarisht të detyrimit që përmban Titulli i Ekzekutimit Vendimin Nr.158 date 02/06/2021 te Gjykates se Apelit Tirane, duke respektuar afatin 10-ditor, që prej marrjes së këtij lajmërimi.

Debitori Shoqeria "Arlis-Ndertim" shpk, me NIPT K82116012N, ka marrë njoftimin e Lajmërimit për Ekzekutimin Vullnetar të Detyrimit dhe nuk i është përgjigjur respektimit të afatit dhe kërkesave të këtij lajmërimi.

Në këto kushte në referim të nenit 519, 527 të K.Pr.Civile është vijuar me ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestër mbi sendet e luajtshme të palës debitore Shoqeria "Arlis-Ndertim" shpk, me NIPT K82116012N, në masën e nevojshme për plotësimin e detyrimit.

Përsa më sipër, në referim të nenit 519, 527 i K.Pr.Civile dhe të Ligjit Nr. 26, Datë 08.05.2019 "Për Shërbimin Përmbartimor Gjyqësor Privat.

URDHËROJ:

1. Vendosjen e shënimit në regjistrat e QKB-së, për subjektin Shoqeria "Arlis-Ndertim" shpk, me NIPT K82116012N, me administrator Zj. Ferzilet Hajdëri, si më poshtë:
 - *Ndalimin e tjetërsimit të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme dhe të drejtave reale mbi kredit e debitorit, Shoqeria "Arlis-Ndertim" shpk, me NIPT K82116012N, me administrator Zj. Ferzilet Hajdëri, duke paralajmëruar çdo zyrë noteriale se çdo akt i ndërmarë pas këtij shënimi përbën shkelje ligjore referuar nenit 531 e vijues të K.Pr.Civile, të Ligjit nr.7829 datë 01.06.1994 " Për noterinë" dhe nenit 428 dhe 320 i K.Penal.*
2. Ky urdhër të qëndroj i regjistruar në regjistrat e QKB-së deri në shlyerjen e plotë të detyrimit në zbatim të Titulli i Ekzekutimit, Vendimi Nr.158 date 02/06/2021 të Gjykatës së Apelit Tirane.
3. Për informimin, bllokimin dhe veprimet që duhet të kryeni pas marrjes së njoftimit të këtij urdhri në lidhje me debitorin e sipërpërmendur të njoftohet në rrugë zyrtare brenda afatit administrativ nga ana Juaj.
4. Personat që bëhen pengesë, apo të cilët i paraprijnë ndonjë ndryshimi të mundshëm të pronësisë së pasurive të luajtshme apo të paluajtshme në emër të debitorit përmendur në pikën 1, brenda afatit të përgjigjes zyrtare, që nga dita e njoftimit të këtij urdhri, do të përgjigjen sipas Nenit 606/3 Kodi i Procedurës Civile dhe 320 i Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.
5. Ky urdhër mbahet në 4 kopje, dhe u njoftohet palëve të cilat kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 5 ditëve, nga dita e marrjes dijeni.

Përmbartues GJYQËSOR

Endrit Z. Hasa

